

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR “SHEFQET NDROQI”, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” Tiranë, me objekt “Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare”, për periudhën 01.01.2012 deri 31.12.2013, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 44, datë 30/04/2014, me ndryshim, me nr. 53, datë 30.05.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 1003/6, datë 05/05/2014, dërguar z. Epaminonda FYPE, me detyrë Drejtor i Spitalit Universitar “Shefqet Ndroqi”, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave sa më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjatë auditimit të programimit të buxhetit u konstatuan se nuk janë hartuar dokumentet e Programit Buxhetit Afatmesëm (PBA) sipas udhëzimeve për hartimin e buxhetit të shtetit. Nuk është bërë hartimi i kërkesave buxhetore që kryhen mbështetur në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP), i cili është dokumenti bazë për planifikimin e shpenzimeve buxhetore. Kjo deklaratë, nuk është hartuar mbështetur në dokumente bazë, si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Ky proces duhet të udhëhiqet nga Grupi Strategjik për Buxhetin dhe Integrimin (GSBI), dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), grup i cili nuk është ngritur nga titullari i Njesisë Publike, subjekt i audituar. Nuk është programuar në buxhet zëri të ardhura të ndryshme, megjithëse përvoja tregon se institucioni realizon të ardhura të tilla. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga SUSHNT-ja të merren masat, që për çdo vit të hartohen dokumentet e Programit të Buxhetit Afatmesëm (PBA), sipas udhëzimeve të hartimit të buxhetit të shtetit si dhe të bëhet programimi i të ardhurave dytësore, si zë më vete i buxhetit.

Çdo vit

2. Gjatë auditimit të njesisë publike u konstatuan pa rregullsi në kryerjet e inventarizimeve fizike të aktiveve, në nxjerrjen e urdhrave të ndryshëm, duke filluar nga ngritja e komisioneve për kryerjen e inventarizimeve, mos citimi i legjislacionit përkatës, mos vendosja e numrit të anëtarëve të komisioneve sipas legjislacionit në fuqi, etj. Gjithashtu edhe për nxjerrjet e materialeve jashtë përdorimit nuk është bërë relacioni përmbledhës, për rezultate përkatëse, dhe nuk është vënë në dijeni titullari i kësaj njësie publike, siç përcakton UMF nr. 30, datë 27/12/2011, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, nënkaptulli “Inventarizimi i aktiveve”, pikat 73 deri 87. **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga SUSHNT-ja të merren të gjitha masat, që për kryerjen e inventarizimeve fizike të aktiveve, në përputhje të plotë me Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, i UMF nr. 30, datë 27/12/2011, duke filluar nga ana formale, vendosjen e bazës ligjore e nënligjore, kryerjen e inventarizimeve, nxjerrjet jashtë përdorimit si dhe në përputhje me standardet e kontabilitetit publik.

Çdo vit

3. Nga SUSHNT-ja të merren të gjithë masat, që të përshihet në rregulloren e brendshme të spitalit procedura e menaxhimit të të ardhurave nga parkimi i automjeteve të personave të jashtëm, që hyjnë gjatë ditës në spital, duke përcaktuar me saktësi edhe dokumentacionin e evidentimit të tyre me qëllim të miradministrimit të këtyre vlerave monetare, që për vitin 2013 arrinin në vlerën rreth 85

mijë lekë. Arkëtimet e bëra gjatë ditës, detyrimisht të dorëzohen në arkën e spitalit çdo fillim të ditës pasardhëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjatë auditimit të dokumentimit të lëvizjeve të aktiveve, veprimeve kontabël që janë kryer në këtë njësi publike si dhe duke parë faktet e sjella të ndryshimeve të pasurisë, që janë në administrim e ruajtje, rezulton se nuk janë pasqyruar me dokumentacionin përkatës. E njëjta problematikë vihet re edhe për mënyrën e evidentimit të konsumit të barnave. Farmacia e kësaj njësie publike, që shërben edhe si magazinë, daljet e barnave për vitin 2013 nuk i shoqëronte me fletë dalje të rregullta. Fletë daljet pritëshin, por nuk nënshkruheshin nga farmacia (magazina) si dhe marrësi në dorëzim. Cilësojmë për vitin 2013, pasi në këtë vit ishte aplikuar sistemi elektronik i lëvizjes së tyre. Këto veprime bien ndesh me UMF nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, Kapitulli “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”, pikat 37, 38, 39 e 40. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Njësia publike, të marrë të gjitha masat për të bërë rregullimet e duhura në sistemin e evidentimit dhe regjistrimit të vlerave të aktiveve dhe të inventarit të barnave duke saktësuar edhe punonjësi me përgjegjësi materiale, në zbatim të rregullave financiare dhe kontabël për këtë kategori aktivesh.

Vazhdimisht

5. Gjatë auditimit të realizimit të të ardhurave rezultoi, se janë dhënë objekte me qira për ndërtimet, montimet, instalimet e antenave, vendosjet e pajisjeve elektronike dhe vendosjet e gjeneratorëve të rrymës elektrike, skarave metalike, shiritave tokëzues dhe kablove në fasadën e ndërtesës dhe të terracë si dhe në kolonat vertikale, si pjesë përbërëse të 3 stacioneve BTS, GSM/UMTS, për kompanitë “██████████” sh.a., “██████████” sh.a si dhe “██████████” sh.a. Montimet e këtyre pajisjeve nuk janë shoqëruar me lejet e organeve përkatëse, leje të cilat janë të nevojshme, pasi paraqesin rrezikshmëri si tek pacientët ashtu edhe tek personeli i spitalit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të verifikohet ligjshmëria dhe rrezikshmëria e ngritjes së këtyre antenave duke marrë miratimin nga organet kompetente për montimet e këtyre stacioneve, në të kundërtën të largohen konformë legjislacionit në fuqi.

Menjëherë

6. Gjatë viteve 2012-2013 janë mbajtur proces-verbale nga punonjësit e SUSHNT-së për llogaritjen e normativave mesatare të konsumit të karburantit për të gjitha automjetet, por për caktimin e komisionit përkatës nuk ka ndonjë shkresë nga titullari i institucionit. **Për këtë është rekomanduar që:**

Të merren masa për llogaritjet e normativave të konsumit të karburantit për çdo automjet nga komisioni, që do të miratojë zyrtarisht titullari i institucionit dhe të përcaktohet përgjegjësia për ndjekjen e zbatimit të këtyre normativave.

Menjëherë

7. Në përfundim të auditimit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, rezultoi se strukturat përgjegjëse të SUSHN Tiranë, nuk kanë dijeni mbi kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi për fushën e menaxhimit financiar e kontrollit, duke filluar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, urdhrat e udhëzimet e dala në zbatim të tij.

Nga Titullari i SUSHNT-së duhet të ngrihet një grup pune, i cili të përcaktojë planin e veprimit duke marrë të gjitha masat, që të funksionojë kontrolli i brendshëm, pasi menaxhimi dhe kontrolli i brendshëm, përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin, keqpërdorimin dhe vjedhjen e pasurisë, konformë ligjit nr. 10296, datë

8/7/2010. **Për këtë është rekomanduar që:**

i) Të rindërtohet organigrama e organizimit dhe funksionimit të institucionit të SUSHNT-së, ballafaquar me kërkesat dhe përgjegjësitë e cilësuar në Kreun II, neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", pika 8 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010, ku përcaktohet se: "*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: germa "ç", që cilëson: "miratimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre"*. Kjo strukturë, jo vetëm që duhet të krijohet, por duhet harmonizuar, përpunuar dhe plotësuar, duke rivendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion në administratën e SUSHNT-së, me qëllim që të ofrohet siguria e duhur se, aktivitetet operative dhe administrative funksionojnë, në pajtim me standardet e mira dhe objektivat strategjike të institucionit.

ii) Referuar faktit se nuk janë hartuar gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emetuara nga Ministria e Financave dhe rrjedhimisht nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme, veprime këto në mospërbushje të kërkesave të nenit 16 "Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit", pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe të detyrimeve të Kapitullit III të "Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 54, datë 15.07.2010, duke u gërshetuar edhe me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 33, datë 11.07.2013, të protokolluar me shkresën nr. 7657/4, datë 11/07/2013, që ka ç'fuqizuar Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 92, datë 29/12/2011, **është rekomanduar që:**

-Nga strukturat përgjegjëse të merren masa për hartimin e gjurmëve të auditimit për procedurat kryesore të menaxhimit dhe administrimit të mjeteve monetare dhe materiale të institucionit dhe të miratohen nga titullari.

Njëkohësisht, të hartohen rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e aseteve, për ruajtjen, administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive publike.

iii) Në SUSHNT-në nuk është hartuar Kodi Etik, mangësi e cila është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, për rrjedhojë punonjësit nuk i nënshtrohen disiplinës së Kodit Etik, në të cilin përcaktohen elementet bazë të sjelljes së mirë administrative, jo vetëm me administratën dhe punonjësit e shërbimit, por edhe sjellja e administratës me personelin dhe pacientet. **Për këtë është rekomanduar që:**

-Nga Sektori i menaxhimit të burimeve njerëzore (Sektori i Personelit) të hartohet Kodi Etik për administratën dhe personelin mjekësor, si dhe të merren masa konkrete procedurale për njohjen e këtij Kodi nga të gjithë punonjësit e këtij institucioni.

iv) SUSHNT-ja disponon Rregulloren e Brendshme, të një modeli të hartuar disa vite më parë (2010), por ajo nuk reflekton të gjitha detyrimet, që burojnë nga ligji "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", **prandaj këtë është rekomanduar që:**

-Të merren masa për rifreskimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të SUSHNT-së, e cila të reflektoje edhe kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010.

v) Nga auditimi rezultoi se SUSHNT-ja nuk ka hartuar Strategjinë për Menaxhimin e Risqeve, kjo në kundërshtim me nenin 8, pika 8/a; 10; 11 dhe 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, si dhe nuk janë përbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Rregjistrit të Risqeve, monitorimin e kontroleve të risqeve, gjë e cila vë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10; 11/2; 12/3, 9/4, germa/c/ dhe 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010. Pra, mungon një regjistër i

identifikimit dhe kontrollit të rrisqeve, ku të adresohen personat përgjegjës për çdo risk, konformë caktimeve të Kreut III të Manualit, "Identifikimi i rrisqeve". **Për këtë është rekomanduar që:**

-Nga nëpunësi autorizues, në cilësinë e koordinatorit të riskut, të merren masa për të hartuar strategjinë dhe rregjistrin e risqeve, në përputhje me nenin 21, të ligjit "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ku të evidentohen risqet që pengojnë arritjen e objektivave të përcaktuara për këtë njësi të qeverisjes publike, si dhe veprimet për minimizimin e tyre.

vi) Nga auditimi u konstatua se nga Nëpunësi Autorizues, nuk është hartuar "Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm", në kundërshtim me nenin 18 të ligjit "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". **Për këtë është rekomanduar që:**

-Nga nëpunësi autorizues të merren masa për të hartuar dhe dorëzuar në institucionin qendror përkatës të vartësisë, brenda afatit të caktuar si për vitin 2014 "Deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm", ashtu edhe për çdo vit pasardhës, në përputhje me "Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Menjherë dhe në vijimësi

8. Nga auditimi rezultoi se në SUSHNT-në ka filluar procesi i informatizimit të qarkullimit të barnave mjekësore, që nga viti 2013. Si rezultat i implementimit të sistemit përkatës, është realizuar lidhja on-line e sistemit farmaceutik. Ajo çka është e rëndësishme, nëpërmjet këtij sistemi, është informacioni që duhet të kenë shefat e shërbimeve, në kohë reale, për të zgjedhur medikamente alternative, në mungesë të një medikamenti të përshkruar nga mjeku në kartelë. Sikurse konstatohet, nëpërmjet implementimit të sistemit përkatës, realizohet informatizimi i farmacisë por jo deri tek shefi i shërbimeve, kryeinfermierit si dhe deri tek pacientët. Pa informatizuar mbeten disa segmente si shefat e shërbimeve, Kryeinfermieri dhe pacienti, të cilët janë në vetvete segmente të pakontrolluara. Pra, aktualisht ***këto segmente janë të pakontrolluara në zinxhirët e përdorimit të barnave dhe që zënë një përqindje të lartë të fondeve të buxhetit të shtetit.*** **Për këtë është rekomanduar që:**

Nga SUSHNT-ja, t'i kërkohet me prioritet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave financimi i sistemit përkatës-Farmaci, dhe Sistem-Raporte dhe implementimi i tij, deri në pikën fundore, që është pacienti, me synimin e mirëmbajtjes, shtrirjes dhe aplikimit të tij deri tek pacienti; mundësimin e dixhitalizimit të kartelave të pacientit, mënyrën e evidentimit të sigurimit të barnave nga vetë pacienti duke synuar kështu rritjen e nivelit e transparencës së përdorimit të barnave dhe medikamenteve si dhe vënien nën kontroll dhe mbikëqyrjen e këtyre segmenteve.

Në vijimësi

9. Nga auditimi i procedurave të prokuruar të fondeve publike, fokusuar në realizimin e qëllimit të ligjit si dhe në parimet themelore të prokurimit publik, si: rritja e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik; sigurimi i mirë përdorimit të fondeve publike dhe të uljes së shpenzimeve procedurale; nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë dhe nxitjes së konkurrencës ndërmjet tyre; sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë konkurrentët pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik, si dhe trajtimit të barabartë të ofertuesve, transparencës në procedurat e prokurimit, dhe barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve, për përdorimin efektiv të fondeve publike, u konstatuan mangësi të njëjta, për procedurat e audituara, të lidhura me mungesën e harmonizimit të punës midis Njësisë së Prokurimit Publik dhe KVO-ve si dhe qëndrime të ndryshme teknike të këtyre strukturave, interpretime dhe keqinterpretime të cilat ndikojnë edhe në nxitjen e ulët të konkurrencës si dhe në copëzimin e fondeve publike në këto tenderime. Bazuar në këtë fakt në drejtim të përmirësimit të

punës, që do të shoqërohej me një efikasitet të plotë të fondeve, në arritjen e objektivave të këtij institucioni, **është rekomanduar që:**

i) Nga SUSHNT-ja të merren masa, për të përmirësuar përbërjen e Njesisë së Prokurimit Publik duke bërë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit Publik, nëpërmjet APP-së, për çështjet e prokurimit publik, në përmbushjes kjo të kërkesës së VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshimet, Kreu V, pika 1, germa “b”.

Menjëherë dhe në vijimësi

ii) Nga Njësia e Prokurimit Publik, për të ardhmen, të merren të gjitha masat, që kërkesat kualifikuese të veçanta, të hartohen në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit, që kërkohet të prokurimet, të vendosen kritere të nevojshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të jenë shumë të kuptueshme deri tek bizneset e vogla si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik. Për kërkesat kualifikuese të miratuara, detyrimisht të kërkohen shoqërimet me dokumentet vërtetues si dhe të përcaktohen organet përkatëse, që lëshojnë dokumente të tilla vërtetuese. Gjithashtu kërkesat kualifikuese të veçanta të miratuara për konkurruesit, detyrimisht të argumentohen, duke shpjeguar arsyet përkatëse. Të gjitha këto në respektim edhe të neneve nr. 46 dhe 55 të LPP.

iii) Nga SUSHNT-ja të merren masa, që të caktohen anëtarë të KVO-ve vetëm specialistë të fushës, sipas tenderave objekt prokurimi, kjo në respektim të kërkesës së VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshimet, Kreu V, pika 2, germa “ç”.

iv) Nga KVO-të të merren masa, që fituesit e shpallur nga realizimi i tenderave, detyrimisht duhet të jenë me plotësim 100% të kërkesave kualifikuese të miratuara nga Njësia e Prokurimit Publik, e kjo në zbatim të rregullave të prokurimit publik, ku cilësohet se mos plotësimi i kërkesave kualifikuese është kusht s’kualifikimi. Gjithashtu, kur ka konkurrentë që paraqiten me vlera të vogla, vetëm për rastet që ka devijime të vogla, natyrisht, kur të gjithë konkurrentët paraqiten me ndonjë mos plotësim të kërkesës kualifikuese dhe mund të riparohen në vazhdim të procedurës së prokurimit, Autoriteti Kontraktor duhet të përdorë edhe pikën nr. 4 të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, e LPP, që cilëson: *“Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”*.

Sipas rasteve

v) Nga komisionet e llogaritjes së fondeve limit dhe caktimit të specifikimeve teknike të blerjeve, shërbimeve apo ndërtimeve, të merren masa, që të përcaktohen shumë qartë specifikimet teknike, për t’u kuptuar qartësisht nga të gjithë, madje edhe nga personat me aftësi të kufizuara, kjo në zbatim të nenit 23 “Specifikimet teknike”, pika 1 e LPP, që cilëson: *“Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara”*.

Në vijimësi

vi) Nga SUSHNT-ja, për të ardhmen, të merren të gjitha masat, që procedurat e prokurimit publik, të fillojnë që në ditët e para të muajit Janar e të vazhdojnë deri në momentin e shpalljes së fituesit, duke pritur për aq kohë, sa do të çelen fondet përkatëse, e jo siç është vepruar deri tani, që kanë filluar nga muaj Mars. Sa më sipër konformë VKM nr. 1, datë 10/01/2007 me ndryshimet, Kreu V “Zhvillimi i procedurave”, germa (ç), që cilëson: *“Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe kur ka nevojë për punë, mallra dhe shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit.....Zhvillimi i procedurës së prokurimit në këtë rast do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet*

..... vetëm pasi fondet do të jenë në **dispozicion (në llogaritë përkatëse)** të autoriteteve kontraktore”.

Kjo do të bëjë të mundur kufizimin e përdorimit të tenderave të blerjes së barnave me procedurat: “me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës” dhe “blerjet me vlera të vogla”.

vii) Nga SUSHNT-ja të merren masa, që përdorimi i procedurave: “me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës” dhe “blerjet me vlera të vogla”, të bëhen vetëm në qoftë se plotësojnë saktësisht kushtet e përcaktuara në legjislacionin përkatës të prokurimeve publike, e konkretisht:

a- VKM nr. 1, datë 10/01/2007 me ndryshimet, Kreu IV “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, pika 5 “Procedura me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, germa (a), paragrafi –“e një nevojë ekstreme”, që cilëson: “e një nevojë ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor. Në këto raste duhet të ekzistojnë kushtet e mëposhtme: duhet të ketë ndodhur një ngjarje e paparashikuar; ngjarja nuk duhet të shkaktohet nga Autoriteti Kontraktor; ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të komunitetit përkatës; duhet të jetë e pamundur të ndiqen standardet”.

Edhe kur për arsye, që lidhen me të **drejtat ekskluzive**, kontrata mund të ekzekutohet vetëm nga një Operator Ekonomik i veçantë, kjo dispozitë duhet interpretuar rigorozisht. Nuk mjafton vetëm mbrojtja e të drejtave ekskluzive për produktet në fjalë(barnat). Duhet, gjithashtu, të krijohen kushtet, që këto produkte të prodhohen ose dërgohen vetëm nga një furnizues i veçantë. Ky kusht përmbushet vetëm në rastin e produkteve për të cilat nuk ka konkurrencë në treg.

b- VKM nr. 1, datë 10/01/2007 me ndryshimet, Kreu VI, pika 2 “Prokurim me vlerë të vogël”, germa (a), që cilëson: “..... Si rrjedhim, për përcaktimin e kufirit monetar për këtë **procedurë llogariten grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme**, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe që, në asnjë rast, **nuk duhet të ndahen** për përdorimin e kësaj procedure”.

Pra, për të ardhmen rekomandojmë, që procedura me blerje të vogla të ndërpritet për grupe mallrash apo shërbimesh të ngjashme, që kalojnë kufirin 400,000 lekë në vitin kalendarik.

Menjëherë dhe në vijimësi

viii) Nga KVO-të e SUSHNT-së të merren masa për të ardhmen, që në procedurën e tenderit të përdorur “me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, të bëhen negociimet përkatëse me operatorët ekonomik konkurrues dhe jo të shpallet fituesi sa është fondi limit i përcaktuar nga autoriteti kontraktor si dhe të kalojnë me rigorozitet të gjitha hapat që janë përcaktuar. Kjo në respektim të legjislacionit të prokurimit publik, e konkretisht të Manualit të Agjencisë së Prokurimit Publik, pika 3.2, që cilëson mes të tjerave: “Negociohet me Ofertuesit e Kualifikuar të Seleksionuar si dhe për çdo veprim të kryer duhet regjistruar në procesverbalin përkatës”.

Menjëherë dhe në vijimësi

ix) Nga SUSHNT-ja të merren masa, që të mos kalohet asnjë blerje apo shërbim me procedurë të vogël, pa u kaluar nëpërmjet platformës elektronike, në respektim kjo të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, VKM nr. 659, datë 03.10.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik me mjetet elektronike” Kreu IV, pika 18 e 19 si dhe Udhëzimit të APP Nr. 7, datë 20/12/2012 “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit elektronik për autoritet kontraktore dhe operatorët ekonomikë”.

Vazhdimisht

x) Nga SUSHNT-ja të merren të gjitha masat, që për të ardhmen të mos ndiqet më metoda e blerjes së lëndës djegëse (pellet), duke u shoqëruar në përfshirjen e çmimit edhe çmimi i marrjes me qira të kaldajës, çka i ka hapur rrugën kontraktimit vetëm të një operatori ekonomik, për disa vite me radhë. Të gjenden mundësi, për të blerë kaldajë të re, por edhe në pamundësi blerje, të zhvillohet tender më vete. për marrjen e kaldajës me qira si dhe tender më vete, për blerjen e lëndës djegëse për ngrohje (pellet).

Menjëherë dhe Vazhdimisht

10. Nga auditimi i procedurave të kryerjeve të pagesave nëpërmjet kësaj Njësie Publike për llogari të enteve të Sektorit Privat apo Shtetëror, të realizuar direkt nëpërmjet thesarit, në llogaritë bankare të përfituesve, ku procedon me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit, fokusuar në vërtetësinë e praktikave dokumentare shoqëruese e argumentuese si dhe mos lënien e shtigjeve për hamendime të ndryshme, **është rekomanduar që:**

i) Nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të merren masa, që të mos nënshkruhet asnjë urdhër shpenzimi për ti dhënë rrugë pagesave, nëpërmjet bankës, për shërbime e riparime të ndryshme, si të: fotokopjeve, kompjuterëve, rojeve, internetit, mirëmbajtjes së ashensorëve, etj. të këtyre natyrave, pa u nënshkruar më parë, faturat tatimore, nga punonjësi përkatës, përgjegjës i SUSHNT-së.

ii) Nga Sektori i Financës të merren masat, që urdhër shpenzimet e kaluara për kryerjen e pagesave pjesore, si për blerjet ashtu edhe për shërbimet, detyrimisht të shoqërohen ose të plotësohen me fatura të rregullta tatimore, para se të kryet likuidimi përfundimtar.

Vazhdimisht

11. Nga SUSHNT-ja të merren masa, që ti kërkohet me prioritet Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shëndetësisë, gjetjen e burimeve financiare, qoftë edhe me të ardhurat e vetë të spitalit, për të mbyllur paaftësinë paguese të viteve të kaluara si dhe në vazhdimësi, të ndërpriten rregullat e vendosura për kryerjet e pagesave pjesore gjatë vitit.

Vazhdimisht deri në dhënien e plotë të tyre

12. Nga SUSHNT-ja të merren të gjitha masat, që të ndërpriten kryerjet e pagesave të gjobave për mos likuidim në kohë të pagesave të telefonisë fikse të Albtelekomit si dhe atyre rasteve, që vijnë nga Bashkia Tiranë, edhe pse janë në raste të pakta, në të kundërtën shumat e gjobave të vendosura të vihen në ngarkim të personave përgjegjës (shkaktar).

Vazhdimisht

13. Nga SUSHNT-ja të merren të gjitha masat, që për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë të zbatohet VKM nr. 864, datë 23/07/2010 pika 2, pasi VKM nr. 343, datë 11/07/ 2002 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, është shfuqizuar.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim për shpërblimin me efekt negativ financiar për vlerën **320,242.30 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

a. Për dëmin ekonomik nga Kompania [REDAKTUAR], me administrator [REDAKTUAR] në vlerën prej **32,586,30 lekë** (29,993.75 lekë internet nëpërmjet ADSL-së (pa lidhur kontratë) dhe 2,592.55 lekë për kamat vonesat të Albtelekomit), në një kohë që funksiononte linjë e rregullt interneti me një kompani tjetër, për 5 raste të kryerjeve të pagesave të numrit të telefonit fiks 2309088, që është përdorur me iniciativën e Kompanisë [REDAKTUAR], që ka fituar tenderin e zhvilluar në vitin 2013 me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të farmacisë “SIIS”, sipas aneksit nr. 3, bashkëlidhur.

b. Për dëmin ekonomik në vlerën prej **28,656 lekë**, nga subjekti [REDAKTUAR], me NIPT [REDAKTUAR], që në faturat e lëshuara për shërbimet mujore telefonike ka llogaritur interesa për vonesa në likuidimet e vlerave monetare, kamat vonesa që janë likuiduar nga institucioni për periudhën Janar 2012 deri

Dhjetor 2013 sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur, në të kundërtën të arkëtohet nga [REDACTED], me detyrë ish Zv/Drejtores Ekonomike e në cilësinë e ish Nëpunësit Zbatues.

c. Për shpenzimin joefektiv [REDACTED], në tenderin e zhvilluar nëpërmjet platformës elektronike me objekt: “Blerje pajisje hotelerie për SU Shefqet Ndroqi” Tiranë”, me nr. reference 77657, datë 27/05/2013, për sa shpallur fituesi i tenderit operatori ekonomik “[REDACTED]” pa plotësuar 100% kërkesat kualifikuese, në një kohë që Autoriteti Kontraktor ka s’kualifikuar edhe operator ekonomik konkurrues, i kërkojmë institucionit që në raste të tilla në zbatim të nenit 53, pika 4 të LPP, të ketë gjithmonë një analizë shpjeguese për shkaqet, bazën e vendimmarrjes së tillë apo korrigjimet që bëhen pa prekur përmbajtjen e ofertës, dokumente që duhen të jenë pjesë e dosjes së tenderit.

d. Për dëmin ekonomik në vlerën prej 101,000 lekë, të Kompanisë celulare “[REDACTED]”, për kontratën e qirasë me periudhë kohore të shfrytëzimit të tarracës së godinës së spitalit, nga data 15/09/2012 deri datë 14/09/2013, porse nuk ka shlyer vlerën e plotë të vitit 2013 si dhe llogaritjen e kamat vonesave.

e. Për dëmin ekonomik në vlerën prej 158,000 lekë, Kompanisë celulare “[REDACTED]”, për kontratën e qirasë me periudhë kohore të shfrytëzimit të tarracës së godinës së spitalit nga data 13/04/2012 deri 12/04/2013 si dhe nga data 13/04/2013 deri datë 12/04/2014, që për periudhën e 6/mujorit të dytë të vitit 2012 nuk ka kryer pagesën në vlerën prej 48,000 lekë si dhe për gjithë vitin 2013 me vlerë 96,000 lekë, si dhe duke përfshirë edhe penalitetet.

Brenda datës 30/06/2014

KONTROLI I LARTË I SHTETIT